

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 01/2007 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 1 janar 2007 – 28 shkurt 2007

Titujt kryesor

- Kuvendi diskuton raportin e përfaqësuesit special të OKB-së për statusin e Kosovës
- Kuvendi miraton raportin me rekomandime të komisionit hetues *ad hoc* lidhur me shpenzimet e Kuvendit më 2004-2005
- Z. Bislim Hoti bëhet anëtar i ri i Kryesisë
- Kuvendi vendos që ta rishpall konkursin për Avokatin e Popullit
- Kuvendi diskuton për situatën e tre shqiptarëve të Kosovës të akuzuar nga Tribunali i Hagës
- Kuvendi shpall 27 prillin ditë të përkohshme të personave të pagjetur

Raporti i pesëdhjetë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur pesë seanca plenare të rregullta, më 11 janar, 26 janar, 8 shkurt, 9 shkurt dhe 22 shkurt si dhe gjashtë mbledhje të Kryesisë, më 9 janar, 12 janar, 22 janar, 5 shkurt, 6 shkurt dhe 19 shkurt. Dhjetë komisionet dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike i kanë mbajtur mbledhjet gjatë periudhës raportuese.¹ Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 22 prej 45 mbledhjeve të komisioneve, një mbledhje të nënkomisionit për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike, dhe një dëgjim publik.²

¹ Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 16 dhe 31 janar dhe më 13 dhe 28 shkurt derisa Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim është takuar më 15, 25 dhe 31 janar dhe 7 e 21 shkurt. Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 15, 22 dhe 29 janar dhe 12 e 19 shkurt derisa Komisioni për siguri është takuar më 17 janar dhe 7 shkurt. Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 25 janar dhe 27 shkurt derisa Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur është takuar më 16 dhe 30 janar, 1, 6, 15, 20 dhe 27 shkurt. Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 9, 19 dhe 22 janar, 6, 13 dhe 20 shkurt derisa Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 9, 16 dhe 23 janar, 13, 20 e 27 shkurt. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 9, 24 dhe 31 janar, dhe 14 shkurt derisa Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet Euro-Atlantike është takuar më 29 janar, 5, 8 dhe 21 shkurt. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe kërkesa dhe parashtrësia publike është takuar më 17 dhe 24 janar, dhe 6 e 21 shkurt. Komisioni për buxhet dhe financa më 17 janar 2007 ka mbajtur dëgjimin publik të projektligjit për TVSH-në. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport, më 23 janar 2007 ka mbajtur dëgjimin publik të projektligjit për bibliotekat. Komisioni për siguri më 23 janar 2007 ka mbajtur dëgjimin publik me Trupat Mbrojtëse të Kosovës.

² Komisioni për buxhet dhe financa më 16 janar dhe më 13 e 28 shkurt; Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim më 25 janar dhe 21 shkurt; Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe Kornizë Kushtetuese më 15 dhe 22 janar dhe 12 e 19 shkurt; Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe persona të zhdukur më 30 janar; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 19 janar e 6 shkurt; Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 9 janar e 13 shkurt; Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 9 janar dhe 14 shkurt; dhe Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet Euro-Atlantike më 29 janar, 5 dhe 21 shkurt. Dëgjimin publik të projektligjit për bibliotekat më 23 janar.

1. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 11 janar e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Tetëdhjetë e katër deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 11 janarit.³
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 11 janarit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për kimikate (Projektligji është miratuar në parim me 60 vota për dhe 17 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për numrin personal (Projektligji është miratuar në parim me 66 vota për dhe pesë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për emrin personal (Projektligji është miratuar në parim me 68 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për transformimin e poseduesve të paluajtshmërive private në pronarë (Projektligji i është kthyer sponzoruesit. Shiko paragrafin e parë të “Procesi legjislativ”.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për sigurinë në trafikun rrugor (Shiko paragrafin e dytë të “Procesi i votimit”.)
 - Shqyrtimi i projekt planit hapësinor 2005-2015 të Kosovës (Plani hapësinor është miratuar me 64 vota për dhe katër vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit për emërimin e dy anëtarëve në Bordin e Mediave për Ankesa propozuar nga Gjykata Supreme e Kosovës (Propozimi për miratim është miratuar me 65 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
 - Emërimi i anëtarit jo-serb dhe jo-shqiptar në Kryesi (Emërimi është miratuar formalisht nga Kuvendi me shumicë votash për dhe pa vota kundër. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve”.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit lidhur me transferimin e fondeve në Ministrinë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural (Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës. Shiko më poshtë paragrafin e parë të pjesa e titulluar “Rendi i ditës”.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 26 janar e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Shtatëdhjetë e pesë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 26 janarit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 26 janarit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit 2003/25 për Kadastrin (Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Arbitrazhin (Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për mbrojtjen e varieteteve të bimëve (Projektligji është miratuar me 69 vota për dhe pa vota kundër.)
 - Debatimi për sigurinë në Kosovë (Z. Jakup Krasniqi (PDK) bëri deklaratën hyrëse, pasuar nga Ministri i Punëve të Brendshme Fatmir Rexhepi, debati plenar dhe deklaratat mbyllëse të Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe z. Jakup Krasniqi.)

³ Përveç nëse është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër në këtë raport, kjo është shifra e njoftuar nga Kryetari i Kuvendit apo Kryesuesi në fillim të ditës.

- Shqyrtimi i propozimit të grupit parlamentar ORA lidhur me zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve.
(Propozimi është miratuar pa vota kundër.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 8 shkurt e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Shtatëdhjetë e tre deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 8 shkurtit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 8 shkurtit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
 - Miratimi i projektligjit për sigurinë në trafikun rrugor
(Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër. Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa e titulluar “Procesi i votimit”.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e ligjit 2003/17 për prokurimin publik
(Projektligji është miratuar me 66 vota për dhe një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për raportimin financiar të ndërmarrjeve
(Projektligji është miratuar me 64 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për shpronësim
(Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i kërkesës së grupit parlamentar të AAK-së për miratimin e rezolutës për Diasporën Kosovare
(Znj. Gjylnaze Syla (AAK) bëri paraqitjen, pasuar nga shefat e grupeve tjera parlamentare. Kuvendi e shtyu miratimin e rezolutës për një fazë të mëvonshme për t’u mundësuar grupeve parlamentare që të mirren vesh lidhur me tekstin konsensual të rezolutës.)
 - Debatimi për situatën e tre shqiptarëve të Kosovës të akuzuar nga Tribunali i Hagës⁴
(Z. Nait Hasani (PDK) bëri deklaratën hyrëse pasuar nga shefat e grupeve parlamentare dhe disa deputetë të Kuvendit.)
 - Shqyrtimi i propozimit për ta shpallur datën 27 prill si ditë të përkohshme të personave të pagjetur⁵
(Kuvendi e miratoi propozimin me shumicë votash për dhe një votë kundër.)
 - Informata nga Kryesia lidhur me vendimin për rishpalljen e konkursit për Avokatin e Popullit dhe zëvendësin kryesor të Avokatit të Popullit
(Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Emërimi i Avokatit të Popullit dhe zëvendësit kryesor të Avokatit të Popullit”.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 9 shkurt e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe bashkëkryesuan anëtarët e Kryesisë z. Sabri Hamiti (LDK) dhe z. Xhavit Haliti (PDK).

- Njëqind e dy deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 9 shkurtit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 30 nëntorit:
 - Debatimi për propozimin e të dërguarit special të OKB-së për statusin e Kosovës

⁴ Z. Nait Hasani (PDK) i mbështetur nga z. Ramë Buja (PDK), z. Xhevat Bislimi (PDK), z. Bajrush Xhemajli (PDK), z. Hajredin Hyseni (PDK), dhe znj. Sala Berisha-Shala (PDK) ka bërë kërkesën për debat mbi situatën e tre shqiptarëve të Kosovës të akuzuar nga Tribunali i Hagës. Në kërkesë nuk janë dhënë emrat e të akuzuarve, por, gjatë diskutimit është bërë e qartë se bëhej fjalë për z. Ramush Haradinaj (ish Kryeministër i Kosovës), Lah Brahimaj dhe Idriz Balaj.

⁵ Propozimi për ta shpallur 27 prillin Ditë të Personave të Pagjetur është bërë nga z. Kamber Kamberi (LDK), mbështetur nga znj. Samije Zeqiraj (LDK), znj. Remzije Nimani (LDK), z. Nimon Alimusaj (LDK), znj. Sanije Aliaj (LDK), z. Ymer Muhaxheri (LDK) dhe z. Jonuz Kastrati (LDK). Në propozimin e tij, z. Kamberi ka deklaruar se “më 27 prill 1999 në fshatin Meje (komuna e Gjakovës/Djakovica) ka ndodhur masakër ku mbi katërqind njerëz ishin vrarë apo rrëmbyer në një ditë.” Ai më tutje propozoi që 27 prilli të shpallet si ditë e përkohshme e personave të pagjetur derisa kjo çështje të rregullohet me ligj.

(Në fillim të debatit të gjithë anëtarët e Grupit të Unitetit bënë deklaratë, pasuar nga shefat e grupeve parlamentare, debati i gjërë, dhe deklaratat mbyllëse të të gjithë anëtarëve të Grupit të Unitetit.)

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 22 shkurt e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK).

- Tetëdhjetë e dy deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 22 shkurtit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 22 shkurtit:
 - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për letërnjoftimin (Projektligji është miratuar në parim me 64 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për shëndetin publik (Projektligji është miratuar në parim me 66 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për sigurimet shëndetësore (Projektligji është miratuar në parim me 68 vota për dhe një votë kundër.)
 - Diskutimi i raportit të komisionit hetues *ad hoc* për shpenzimet e Kuvendit për vitet 2004-2005⁶ (Raporti i komisionit hetues ku përfshihen edhe dymbëdhjetë rekomandime, është miratuar me shumicë votash për dhe pesë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në Bordin Drejtues të Autoritetit Bankar Qëndror (Kjo pikë është hequr me kërkesë të Qeverisë si sponsorues.)
 - Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në Bordin për Ujërat (Kjo pikë është hequr. Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa e titulluar “Rendi i ditës”.)

2. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Në fillim të seancës plenare të 11 janarit, z. Naser Osmani (LDK), kryesues i Komisionit për buxhet, *gojarisht* propozoi që pika e rendit të ditës për bartjen e fondeve në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të heqet nga rendi i ditës me arsyetimin se një bartje e tillë është dashur të propozohet gjatë vitit fiskal 2006. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin e z. Osmani, i cili u miratua me shumicë votash për.
Në fillim të seancës plenare të 22 shkurtit, Komisioni për çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese propozoi *me shkrim* që në rendin e ditës të përfshihet edhe pika për emërimin e gjykatësve. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin, i cili është refuzuar me shumicë votash kundër. Gjatë së njëjtës seancë, znj. Selviqe Halimi (PDK) *gojarisht* propozoi që pika e rendit të ditës për emërimin e anëtarëve në Bordin për Ujërat të heqet nga rendi i ditës. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin, i cili është miratuar me shumicë votash për.
Rregullat e reja 23.1-2 parashohin që “Kryesia përgatitë një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës të Kuvendit dhe menjëherë të njëjtin e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit. Në fillim të seancës ky propozim rend dite do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 deputetë i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament në rendin e ditës, i cili hidhet në votim.” Propozimi i Komisionit për çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese i parashtruar më herët me shkrim, është bërë në pajtim me rregullat e reja. Por, z. Osmani dhe znj. Halimi bënë propozime në pajtim me rregullën e mëparshme,⁷ e cila nuk është në fuqi nga qershori 2006, dhe e cila lejonte që

⁶ Për më shumë detaje shiko raportin 07/2006 të shtyllës së III-të (OSBE), pjesën e titulluar “Themelimi i Komisionit Hetues *ad hoc*”.

⁷ Rregulla e mëparshme 23.1 parashihte që “Në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme. Ky propozim konsiderohet i miratuar, përveç në rastet kur një ose më shumë grupe parlamentare ose ... gjashtë deputetë e kundërshtojnë këtë.”

propozimet për ndryshimin e rendit të ditës të bëhen me gojë. Edhe pas ripunimit të dispozitave lidhur me caktimin e rendit të ditës në seancën plenare të 1-2 qershorit 2006, deputetët e Kuvendit kanë vazhduar të propozojnë amendamente në rendin e ditës, me shkrim dhe me gojë. Dispozitat e reja të cilat kërkojnë që amendamentet në rendin e ditës së seancave plenare të propozohen me shkrim duhet të respektohen vazhdimisht për t'i ikur paqartësive apo pakënaqësisë së deputetëve të Kuvendit.

Shpërndarja e dokumentave

- Projektligji për Kimikatet u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit më 13 dhjetor 2006, derisa Projektligji për Numrin Personal dhe Projektligji për Emrin Personal janë shpërndarë më 20 dhjetor 2006. Andaj, projektligjet janë shpërndarë respektivisht 17 dhe dymbëdhjetë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 11 janarit. Projektligji për Letërnjoftimin është shpërndarë më 31 janar. Andaj, projektligji jështë shpërndarë respektivisht 15 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 22 shkurtit.
Kjo ishte në pajtim me rregullën 35.1 e cila parasheh që shqyrtimit i parë i projektligjit të bëhet jo më herët se dhjetë ditë pune dhe jo më vonë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes. Kjo paraqet përmirësim për dallim nga periudhat e mëparshme raportuese kur shumica e projektligjeve janë shqyrtuar për herë të parë pas më shumë se tri javë pune pas datës së shpërndarjes së tyre.

Procesi legjislativ

- Projektligji për Sigurinë në Trafikun Rrugor është miratuar më shumë se dhjetë muaj pas shqyrtimit të tij të parë më 16 mars 2006. Projektligji për Ndryshimin e Ligjit për Kadastrin dhe Projektligji për mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve janë miratuar gati pesë muaj pas shqyrtimit të tyre më 31 gusht 2006. Projektligji për Arbitrazhin është miratuar nëntë muaj pas shqyrtimit të tij të parë më 27 prill 2006. Projektligji për Ndryshimin e Ligjit Nr. 2003/17 për Prokurimin Publik është miratuar katër muaj pas shqyrtimit të tij të parë më 9 tetor 2006. Projektligji për Raportimin Financiar të Ndërmarrjeve është miratuar gati tetë muaj pas shqyrtimit të parë më 15 qershor 2006. Projektligji për Shpronësimin është miratuar më shumë se pesë muaj pas shqyrtimit të parë më 31 gusht 2006. Projektligji për Shëndetësinë Publike është miratuar dy vite pas shqyrtimit të parë më 31 janar 2005.
Rregulla 35.6 parasheh që “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi”. Komisionet e Kuvendit i kanë paraqitur rekomandimet e tyre në shumicën e projektligjeve të lartëpërmendura me një vonesë të konsiderueshme nga afati i përcaktuar me rregullën 35.6, pa kërkuar nga Kuvendi shtyerjen e afatit. Komisionet e Kuvendit duhet ta shpejtojnë shqyrtimin e projektligjeve për t’ju përmbajtur afatit të përcaktuar në rregullën e lartëshënuar. Vonesat në shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve theksojnë nevojën për planifikim më të mirë të planit legjislativ në mes të Kuvendit dhe Qeverisë.
- Në seancën plenare të 11 janarit, znj. Nekibe Kelmendi (LDK), kryesuese e komisionit funksional (Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media), propozoi që Projektligji për Transformimin e Poseduesve të Paluajtshmërive Private në Pronarë, i cili ishte radhitur për shqyrtim të dytë në seancën plenare të asaj dite, t’i kthehet sponsoruesit me arsyetimin se shumë nga nenet e tij tashmë ishin përfshirë në ligje tjera dhe se nenet e mbetura mund të rregullohen me një akt nënligjor. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin e z. Kelmendi, i cili është miratuar me shumicë votash për.
Rregulla 35.3 parasheh që “Propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit të parë deri para fillimit të procedurës së votimit për miratim në parim.” Në mënyrë analoge, komisioni funksional është dashur t’i propozojë Kuvendit që ta kthejë projektligjin për Transformimin e Poseduesve të Paluajtshmërive Private në Pronarë sponsoruesit në pajtim me rregullën 35.3. Për më tepër, rregulla 35.7 parasheh që “Komisioni funksional - përgjegjës raportues ose

kryesor, mund ta shqyrtojë projektligjin në parim edhe para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare.” Sikur komisioni funksional ta kishte shqyrtuar projektligjin në fjalë para shqyrtimit të parë siç lejohet me rregullën 35.7, do kishte pasur mundësinë t’i vërejë të metat e projektligjit dhe të propozojë kthimin e tij sponsoruesit gjatë shqyrtimit të parë, në vend se të bënte një propozim të tillë përparësisht dy muaj pas shqyrtimit të parë në seancën plenare të 16 nëntorit 2006. Komisionet e Kuvendit duhet të shqyrtojnë mundësinë e shqyrtimit të projektligjeve para shqyrtimit të parë në mënyrë që procesi legjislativ të jetë më i efektshëm.

Procesi i votimit

- Kuorum ka pasur për të gjitha votimet në seancat plenare që janë nën shqyrtim.
Kjo ishte në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe me rregullën 31.1, të cilat parashohin që për marrjen e vendimeve shumica e deputetëve të Kuvendit duhet të jetë e pranishme.
- Më 18 dhjetor gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për Sigurinë në Trafikun Rrugor, z. Ibush Jonuzi, kryesues i komisionit funksional (komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion), sqaroi se ishin propozuar 242 amendamente në ligjin në shqyrtim, të cilat ishin ndarë në katër grupe nga komisioni funksional: (I) 182 amendamente të propozuara nga komisioni funksional, (II) 49 amendamente të propozuara bashkarisht nga komisioni funksional dhe komisioni për buxhet, (III) 10 amendamente të propozuara nga Ramadan Kelmendi⁸ dhe (IV) amendamenti i fundit nr. 242, që përfshinte 116 nën-amandamente të natyrës teknike. Ai më tutje propozoi që Kuvendi të votoj *en bloc* për secilin grup të amendamenteve për të kursyer kohë, propozim që u mbështet nga grupet parlamentare të LDK-së dhe AAK-së, por u refuzua nga grupet parlamentare të PDK-së dhe ORA-s. Menjëherë pas miratimit të propozimit për t’i votuar amendamentet *en bloc*, grupi parlamentar i PDK-së doli nga salla plenare duke e lënë seancën pa kuorum. Andaj, shqyrtimi i dytë i projektligjit për Sigurinë në Trafikun Rrugor është shtyrë.⁹
Në seancën plenare të 11 janarit Kryesuesi lajmëroi se Kryetari i Kuvendit ka arritur marrëveshje me shefat e grupeve parlamentare lidhur me votimin e amendamenteve në projektligjin për Sigurinë në Trafikun Rrugor, dhe i dha fjalën z. Alush Gashi (LDK) për ta shpjeguar marrëveshjen. Z. Gashi deklaroi se Kryetari i Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare ishin pajtuar që secili nga grupet e amendamenteve të votohen *en bloc* dhe që komisioni funksional do t’i paraqiste tekstin përfundimtar të projektligjit me të gjitha amendamentet e miratuara Kuvendit për miratim, në seancën plenare të radhës. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) kundërshtoi duke thënë se rregulla 37.2 nuk lejon që amendamentet të votohen *en bloc* përveç nëse një grup amendamentesh kanë ndikim në nenet tjera. Ajo më tutje propozoi që Kuvendi më parë të vendosë që t’i shmanget rregullës 37.2 në mënyrë që t’i votoj amendamentet *en bloc*. Grupet parlamentare të PDK-së, AAK-së, 6+, dhe Për Integrim e mbështetën propozimin për votimin *en bloc* të amendamenteve. Kryesuesi më pas vazhdoi duke hedhur në votim veç e veç secilin nga katër grupet e amendamenteve, prej të cilave tri grupe të amendamenteve janë miratuar me shumicë votash për, përveç grupit të amendamenteve të propozuara nga z. Kelmendi, i cili është refuzuar.
Në seancën plenare të 8 shkurtit Kuvendi e ka miratuar tekstin përfundimtar të projektligjit për Sigurinë në Trafikun Rrugor me të gjitha amendamentet e përfshira, me shumicë votash për.
Rregulla 37.2 parasheh që “Amendamentet shqyrtohen veç e veç sipas radhës që paraqiten në tekstin e projektligjit, përveç nëse ndonjë grup i amendamenteve ka ndikim veprues në nenet e tjera. Në këtë rast ata mund të shqyrtohen aty ku paraqiten së pari në tekst dhe mund t’i nënshtrohen një votimi të vetëm.” Arsyetimi që është dhënë nga kryesuesi i komisionit

⁸ Z. Ramadan Kelmendi ishte deputet i grupit parlamentar të LDK-së deri në fund të periudhës raportuese (28 shkurt 2007). Ai dhe pesë deputetë tjerë nga grupi parlamentar i LDK-së kanë vendosur të formojnë një grup të ri parlamentar, që ka ndodhur jashtë periudhës raportuese në fjalë dhe do të mbulohet në raportin monitorues të radhës.

⁹ Për më shumë detaje shiko raportin 07/2006 të shtyllës III (OSBE), paragrafin e dytë të pjesa e titulluar “Procesi i votimit”.

funksional më 18 dhjetor nuk ka qenë se amandamentet kanë ndikim në njëri-tjetrin por se votimi për secilin amandament veç e veç për një numër kaq të madh të amandamenteve do të merrte shumë kohë.

Rregulla 61 parasheh që “Për shmangiet nga Rregullorja e punës mund të vendos Kuvendi me dy të tretat e shumicës së deputetëve të pranishëm në Kuvend, përveç nëse kjo është në kundërshtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese.” Vendimi për të votuar për amandamentet en bloc nuk do të shkelte asnjë dispozitë të Kornizës Kushtetuese. Andaj, Kuvendi ka mundur të marrë vendim për t’ju shmangur përkohësisht rregullës 37.2 me kusht që propozimi të mbështetet nga dy të tretat e deputetëve të pranishëm, siç parashihet në rregullën 61, dhe të vazhdojë me votimin en bloc të amandamenteve të lartpërmendura.

Emërimi i Avokatit të popullit dhe zëvendësit kryesor të tij

- Në takimin e Kryesisë më 9 janar, Kryetari i Kuvendit e lexoi me zë interpretimin e dërguar nga Zyra e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut, të kërkuar nga Kuvendi gjatë seancës plenare të 14 dhjetorit 2006¹⁰ sipas të cilit “votimi për Avokatin e Popullit dhe zëvendësin kryesor të Avokatit të Popullit më 14 dhjetor nuk mund të konsiderohet përfundimtar pasi që shumica e votave të kërkuara 61 apo më tepër që emërimi i kandidatëve të jetë valid nuk u arrit.” Andaj, Kyesia ka vendosur ta rishpall konkursin për Avokatin e Popullit dhe zëvendësit kryesor të tij. Më 9 janar, PSSP-ja poashtu i ka dërguar një letër Kryetarit të Kuvendit ku ka shpjeguar se “në pajtim me nenet 6.2 dhe 6.5 të rregullores së UNMIK-ut 2006/6 që rregullon Institucionin e Avokatit të Popullit, Avokati i Popullit dhe zëvendësi kryesor i tij do të emërohen ... me votim duke marrë mbështetjen e shumicës së deputetëve të Kuvendit. Andaj, është e qartë se votimi mund të konsiderohet i suksesshëm vetëm nëse shumica, 61 apo më tepër, e të gjithë deputetëve të Kuvendit votojnë për. Prandaj, votimi për emërimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësit kryesor të tij që është bërë më 14 dhjetor nuk mund të konsiderohet përfundimtar meqë shumica e votave të kërkuara që emërimi të jetë valid, nuk është arritur.” Për më tepër, në letër është rekomanduar që “Kuvendi ta ... përsëris votimin me kandidatët e propozuar nga komisioni legjislativ derisa kushti për shumicën absolute të votave të përmbushet.” Në seancën plenare të 11 janarit 2007, Kryesuesi e informoi Kuvendin se Kryesia në mbledhjen e mbajtur më 9 janar ka vendosur ta rishpall konkursin për Avokatin e Popullit dhe zëvendësin kryesor të tij, meqë letra e dërguar nga Zyra e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut nuk rekomandonte hapa tjerë procedural. Por, ai vazhdoi duke thënë se PSSP-ja poashtu e ka dërguar një letër më 9 janar, pas mbledhjes së Kryesisë, ku ka rekomanduar se “Kuvendi duhet ta përsëris votimin me të njëjtit kandidatë derisa njëri nga ta të marrë shumicën absolute të votave”. Ai më tutje deklaroi se Kryesia tashmë e kishte kontaktuar zyrën e PSSP-së për ta qartësuar çështjen dhe i ishte thënë se interpretimi autentik do të ipej në seancën plenare të radhës. Z. Hydajet Hyseni (PDK), kryesues i komisionit për çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese debatoi se nuk ka bazë ligjore për ta anuluar procesin dhe shtoi se Kuvendi dhe zyra e PSSP-së “do të vendosnin kështu një precedent të rrezikshëm dhe do ta shkelnin ligjin.” Ai propozoi që Kuvendi ta përsëris votimin vetëm për kandidatin për Avokat të Popullit, respektivisht zëvendësin kryesor të tij i cili ka marrë numrin më të madh të votave në rrethin e dytë në seancën plenare të 14 dhjetorit, dhe nëse kandidatët nuk marrin numrin absolut të votave, opzione të tjera mund të mirren parasysh. Megjithatë, kjo pikë e rendit të ditës është shtyrë për seancën plenare të radhës.

¹⁰ Në seancën plenare të 14 dhjetorit 2006, Kuvendi ka votuar propozimet e Komisionit për çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese për Avokatin e Popullit dhe zëvendësin kryesor të Avokatit të Popullit. Z. Hilmi Jashari, z. Ibrahim Makolli dhe znj. Diana Toska ishin kandidatët e propozuar për Avokat të Popullit, derisa z. Palë Bala, z. Ljubinko Todorović dhe Habit Hajredini ishin kandidatët e propozuar për zëvendës kryesor të Avokatit të Popullit. Në dy rrahët e votimit asnjëri prej kandidatëve nuk ka marrë shumicën absolute të votave. Deputetët e Kuvendit theksuan se kishte mospërputhje në mes të Rregullores së UNMIK-ut 2006/6 e cila kërkonte shumicën absolute të votave për të qenë emërimi valid, dhe rregullores procedurale të miratuar nga Kuvendi, e cila kërkonte shumicën e thjeshtë. Andaj, Kuvendi vendosi të kërkojë interpretimin e kësaj çështjeje nga Zyra e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut. Për më shumë detaje shiko raportin 07/2006 të shtyllës së III-të (OSBE), pjesën e titulluar “Emërimi i Avokatit të Popullit dhe zëvendësit kryesor të Avokatit të Popullit”.

Në mbledhjen e Kryesisë më 5 shkurt, z. Xhavit Haliti (PDK) informoi se në emër të Kryesisë, ai kishte marrë pjesë në takim me Zyrën e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut dhe OSBE-në, ku ishte diskutuar emërimi i Avokatit të Popullit. Ai deklaroi se konkluzioni i takimit ishte që Kuvendi, ose ta përsëris kandidatin për Avokat të Popullit, respektivisht zëvendësin kryesor të tij i cili ka marrë numrin më të madh të votave në rrethin e dytë të votimit, ose t'i rishpall konkurset. Ai shtoi se kandidati për Avokat të Popullit, z. Ibrahim Makolli¹¹ i cili kishte marrë numrin më të madh të votave në rrethin e dytë të votimit, i ishte bashkuar një partie politike dhe sipas Rregullores 2006/6 ai nuk mund të ishte i propozuar më tutje. Z. Ramë Buja (PDK) deklaroi se nuk kishte konfirmim zyrtar që z. Makolli i ishte bashkuar ndonjë partie politike, por shtoi se megjithatë ishte më mirë që konkursi të rishpallet. Z. Bislim Hoti (IRDK) deklaroi se e kishte parë z. Makolli në një program televiziv, ku z. Makolli kishte deklaruar se i ishte bashkuar një partie politike. Pas një diskutimi të mëtutjeshëm, Kryesia vendosi që t'i rishpall konkurset për Avokat të Popullit dhe zëvendësin kryesor të Avokatit të Popullit.

Në seancën plenare të 8 shkurtit, Kryesuesi e informoi Kuvendin se Kryesia kishte vendosur t'i rishpall konkurset për Avokat të Popullit dhe zëvendësin kryesor të tij. Z. Hyseni deklaroi se vendimi ishte i dëmshëm dhe se ai nuk pajtohej me të. Deputetët tjerë të Kuvendit nuk e kundërshtuan vendimin e Kryesisë.

Vendimi i Kryesisë për t'i rishpallur konkurset për Avokat të Popullit dhe zëvendësin kryesor të Avokatit të Popullit ishte në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut 2006/6 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit, meqë asnjëri nga kandidatët nuk e ka marrë shumicën absolute të votave siç kërkohet me rregullore. Neni 8.1 i rregullores 2006/6 parasheh që "Postet e avokatit të popullit, zëvendësit kryesor dhe zëvendësve të tjerë dhe të personelit të Insitucionit të Avokatit të Popullit janë të papajtueshme me ushtrimin ose mbajtjen e çfarëdo aktiviteti politik, publik apo profesional privat." Individit i cili ushtron aktivitet politik apo mban post politik, nuk mund të zgjedhet Avokat i Popullit. Për më tepër, meqë nuk ka pasur kundërshtim të fuqishëm në Kuvend ndaj vendimit të Kryesisë për rishpalljen e konkurseve, vendimi konsiderohet valid.

Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore

- Në seancën plenare të 11 janarit, asnjëra nga dy pyetje nuk ka marrë përgjigje. Në seancën plenare të 26 janarit, gjashtë nga tetë pyetje kanë marrë përgjigje. Në seancën plenare të 8 shkurtit, një nga tri pyetje ka marrë përgjigje. Në seancën plenare të 22 shkurtit, pesë nga gjashtë pyetje kanë marrë përgjigje. Kryetari i Kuvendit u përgjigj duke thënë se pyetjet që nuk kanë marrë përgjigje brenda dy seancave plenare do të publikoheshin në buletin e Kuvendit.

Koha për pyetjet parlamentare është kryer nga Kuvendi në pajtim me rregullën e re 26 për "Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore", e cila parasheh që rendi i ditës i secilës seancë plenare duhet të përfshijë kohën prej 50 minutash për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë zgjat pyetja, tre minuta përgjigja e Ministrisë, një minutë pyetja shtesë, dhe dy minuta përgjigja në pyetjen shtesë.

Sipas rregullës së re 26.11, "nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave ajo publikohet në Buletin e Kuvendit." Buletini i Kuvendit të Kosovës nuk përmban pyetjet që i janë parashtruar Qeverisë, prandaj asnjëra nga pyetjet që presin përgjigje nuk është publikuar ndonjëherë. Publikimi në buletin e Kuvendit të pyetjeve të deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje do të mund ta rriste përgjegjësinë e Qeverisë ndaj Kuvendit.

4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

¹¹ Asokohe nuk ishte e konfirmuar zyrtarisht se z. Ibrahim Makolli i ishte bashkuar ndonjë partie politike, por më vonë ishte konfirmuar se ai i ishte bashkuar partisë së re "Aleanca për Kosovën e Re" të udhëhequr nga Behxhet Pacolli.

Emërimi i një anëtari të Kryesisë nga radhët e komuniteteve joshqiptare dhe joserbe¹²

- Më 9 janar, sipas kërkesës së Kryesisë, PSSP-ja i ka dërguar një letër Kryetarit të Kuvendit në të cilën shkruante se sipas Kornizës Kushtetuese “i përket komunitetit të përcaktojë përfaqësimin në Kryesi. Ekziston një marrëveshje lidhur me përfaqësimin e “komuniteteve tjera” në bazë rotacioni. Përfaqësimi politik i personit të zgjedhur me këtë marrëveshje është i parëndësishëm.” Në mbledhjen e Kryesisë të mbajtur më 9 janar, Kryetari i Kuvendit ka konstatuar se Kuvendi do të duhej të pranonte propozimin që z. Bislim Hoti (IRDK/egjiptian) të bëhet anëtar i Kryesisë në vitin 2007, sipas marrëveshjes së arritur në mes të IRDK-së, KDTP-së dhe Vakait. Z. Xhavit Haliti (PDK) ka kundërshtuar duke thënë se po të ishte z. Hoti anëtar i grupit parlamentar 6+, do të ishte e arsyeshme që të bëhej anëtar i Kryesisë, por jo si anëtar i grupit parlamentar të AAK-së. Z. Mahir Yağcilar (KDTP/6+) ka konstatuar se ai e mbështeste propozimin që z. Hoti të bëhej anëtar i Kryesisë në vitin 2007. Z. Sabri Hamiti (LDK) ka konstatuar se sipas Kornizës Kushtetuese, AAK-ja nuk mund të kishte dy anëtarë në Kryesi. Kryetari i Kuvendit konkludoi se Kuvendi duhet të vendosë lidhur me përfaqësimin e z. Hoti në Kryesi.

Në seancën plenare të 11 janarit, z. Xhavit Haliti, i cili e kryesonte seancën në atë çast, ka pohuar se janë shprehur dyshime në seancën e mëparshme dhe mbledhjet e Kryesisë lidhur me atë nëse z. Hoti mund të bëhej anëtar i Kryesisë pasi që është anëtar i grupit parlamentar të AAK-së, gjë që “sipas Rregullores dhe Kornizës Kushtetuese nuk lejohet, por PSSP-ja i jep mundësi kandidimit në fjalë”. Kryesuesi e lexoi me zë letrën e PSSP-së dhe pastaj e vëri në votim miratimin formal të emërimit të z. Hoti për anëtar të Kryesisë, i cili është miratuar me shumicë votash për.

Neni 9.1.7 (f) i Kornizës Kushtetuese parasheh që “një anëtar i Kryesisë do të emërohet nga radhët e atyre deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive të cilat janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin joshqiptar dhe joserb. Metoda për emërimin e këtij anëtari të mëvonshëm do të caktohet nga deputetët e Kuvendit që u përkasin komuniteteve të njëjta.” Më tutje, neni 9.1.8 parasheh që “Kuvendi i miraton këto emërimet me anë të një vote formale.” Andaj, Kryesia nuk ka rol në miratimin apo refuzimin e marrëveshjes së arritur nga komunitetet joserbe dhe joshqiptare lidhur me përfaqësimin e tyre në Kryesi. Për më tepër, roli i Kuvendit është vetëm ta miratojë një marrëveshje të tillë me votë formale pa ndërhyrë në marrëveshjen interne të komuniteteve të tjera. Z. Bislim Hoti është propozuar për anëtar të Kryesisë si përfaqësues i komunitetit egjiptian, jo si anëtar i grupit parlamentar të AAK-së. Konstatimet se Rregullorja e Kuvendit dhe Korniza Kushtetuese nuk e lejojnë përfaqësimin e z. Hoti në Kryesi nuk janë të sakta. Miratimi i propozimit lidhur me përfaqësimin e z. Hoti në Kryesi gjatë vitit 2007, i cili ka ndodhur në seancën plenare të 11 janarit, ishte në pajtim me Kornizën Kushtetuese.

5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e rregullta të Kryesisë, dhe në mbledhjet e komisioneve. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

¹² Më 2 dhjetor 2004, KDTP (partia turke), Vakait (partia boshnjake) dhe IRDK (partia egjiptiane), të cilët përfaqësojnë tetë nga dymbëdhjetë deputetë nga radhët e komuniteteve joserbe dhe joshqiptare, kanë arritur marrëveshjen sipas të cilës ata do të përfaqësoheshin në Kryesi mbi bazën e një rotacioni vjetor, ku z. Džezair Murati (6+/Vakat), do të bëhej anëtar i Kryesisë gjatë vitit të parë të mandatit të Kuvendit, pastaj z. Mahir Yağcilar (6+/KDTP) gjatë vitit të dytë dhe z. Bislim Hoti (IRDK) gjatë vitit të tretë. Sipas marrëveshjes, z. Murati tashmë ka qenë anëtar i Kryesisë gjatë vitit 2005 dhe z. Yağcilar që nga janari i vitit 2006. Më 4 dhjetor 2006, z. Bislim Hoti (IRDK/Egjiptian) i ka dërguar një letër Kryesisë duke e informuar atë se ai do të bëhej anëtar i Kryesisë nga janari i vitit 2007, sipas marrëveshjes së lartpërmendur. Megjithatë, disa anëtarë të Kryesisë kanë ngurruar ta pranojnë z. Hoti me arsyetimin se ai nuk mund të ishte anëtar i Kryesisë pasi që është anëtar i grupit parlamentar të AAK-së. Në mbledhjen e mbajtur më 18 dhjetor, Kryesia kishte vendosur të kërkojë interpretimin ligjor të çështjes nga Zyra e PSSP-së. Shiko raportin 07/2006 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit, paragrafi i parë nën “Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve”.

6. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web faqen (www.kuvendikosoves.org, www.skupstinakosova.org, www.assemblyofkosovo.org). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

FUND.